



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ANTIKORRUPSIONIT
DREJTORIA E PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE ANTIKORRUPSION

Raport konsultimi i draft raportit të monitorimit janar-dhjetor 2023, të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023

1. Titulli i draft aktit: Raporti i monitorimit për periudhën janar-dhjetor 2023, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve - Konsultimi i parë (drafti 1) me institucionet zbatuese e raportuese të Planit të Veprimit dhe Departamentin e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit në KM, është bërë në datën 13.3.2024. Në këtë datë, institucioneve zbatuese iu është dërguar draft raporti për komente të mundshme dhe vlerësim nga ana e tyre. Konsultimi i dytë (drafti 2) është kryer në datën 7 maj 2023, dhe ka qenë gjithashtu i hapur në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë. Publikimi është bërë në mars 2023, në menu: prioritet/strategjia ndërsektoriale/strategjia kundër korrupsionit/raporte monitorimi në www.drejtesia.gov.al dhe ka qenë i hapur deri në datën 7 maj 2023.

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për këtë draft raport janë si vijon:

- Dërguar via email institucioneve përgjegjëse e zbatuese të PV SNKK dhe Departamentit në KM/ dërguar draft – raporti i hartuar; dërguar formati i raportimit (për masat dhe aktivitetet); dërguar formati i raportimit (për treguesit e performancës me vlera vjetore), për plotësim me shpjegimet dhe detajet e kërkuara.

- Komunikimi i drejtpërdrejtë via email për çdo kontribut/raportim të marrë; kthim për plotësim informacioni, të dhënash, informacion i munguar dhe komente të ardhura nga data 13.03.2023 - 07.05.2023.

- Faqja zyrtare e MD-së, www.drejtesia.gov.al

- Takim i realizuar është në datë 10.05.2023 - tryezë ndërinstucionale konsultimi, zhvilluar online (institucionet e Qasjes A – parandaluese, B – ndëshkuese, Qasjes C- ndërgjegjësuere).

Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit së të dhënave dhe përmbajtjes së draft raportit, u përcollën:

- nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike në stafin teknik të drejtorisë antikorrupsion rovena.pregja@drejtesia.gov.al dhe klajdi.laska@drejtesia.gov.al
- nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezën e konsultimit të zhvilluar në MD (online).

Gjithashtu Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit shpalli për konsultim publik draft raportin e monitorimit janar-dhjetor 2023, të Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023 edhe për OSHC-të, duke pritur komente, mendime dhe sugjerime nga ta brenda datës 7 maj 2023, në adresën rovena.pregja@drejtesia.gov.al

4. Palët e interesit të përfshira

Draft raporti është konsultuar me përfaqësues të të gjithë institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e PV SNKK dhe të grupeve të interesit në fushën antikorrupsion.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Çështja e adresuar	Palët e interesuara	Vendimi (i pranuar/ i pranuar pjesërisht/ i refuzuar)	Justifikimi
Kërkohet ndryshimi i përqindjes së zbatueshmërisë së objektivit A.1.a për shkak edhe të ndryshimit të numrit të institucioneve të monitoruara.	KMDIDHP	I pranuar	Është reflektuar plotësisht i informacionit të dërguar në aneksin e masave dhe aktiviteteve, dhe përmbajtjen e raportit.
Janë përcjellë të dhënat statistikore për vitin 2023 për veprat penale të korrupsionit, për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm	PP	I pranuar	Këto të dhëna janë integruar në përmbajtjen e raportit si dhe janë vlerësuar në funksion të analizës tërësore
Kërkohet plotësimi i informacionit për aneksin e Planit të Veprimit dhe Pasaportës së Indikatorëve.	AMSHC	I pranuar	Është reflektuar plotësisht i informacionit të dërguar në raport dhe anekset përkatëse
Kontribut mbi statusin e adoptimit të politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore	AMVV	I pranuar	Është reflektuar plotësisht i informacionit të dërguar në raport.

Kërkohe plotësim informacioni për vlerën e treguesit të performancës A.7.c dhe aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit	MFE	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport dhe në aneksin e indikatorëve.
Kërkohe plotësim informacioni mbi treguesit e performancës	PSH	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport dhe në aneksin e indikatorëve.
Kërkohe plotësim informacioni mbi buxhetin e përdorur në realizimin e masave dhe aktivitetëve në Planin e Veprimit	ILDKPKI	I pranuar	Është reflektuar plotësimi i informacionit të dërguar në raport si dhe është rillogaritur buxheti i shpenzuar në total për qasjen parandaluese A.